



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 665, datë 31.10.2024

PËR

PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË Z. {...} DHE CAKTIMIN NË POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 31.10.2024, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet përkatëse, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, “Për Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} dhe caktimin në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”,

V Ë R E N:

I. MBI PROCEDURËN E VERIFIKIMIT PËR EMËRIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 34 pika 6, 53 pika 4, 55 dhe 56 të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim si “Ligji për Pushtetin Gjyqësor”), me vendimin nr. 157, datë 04.04.2023, ka vlerësuar se z. {...} plotësonte kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, profili ndihmës ligjor.

2. Në vijim, mbështetur në nenin 53, të Ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”, si dhe në Vendimin e tij nr. 424/2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, Këshilli, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në

provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës ligjor, viti akademik 2023 - 2024, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat.

2.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, me vendimin nr. 469, datë 31.07.2024 ka vendosur:

1. *Kualifikimin e kandidatit fitues Z. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.*

3. Në përfundim të Programit të Formimit Fillestar, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, rezulton se Shkolla e Magjistraturës, me Vendimin nr. 29, datë 03.07.2024 “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, ka renditur Z. {...} të gjashtin në listën e kandidatëve, me 77.30 pikë (më shumë se 70% të pikëve në total), duke përcjellë dhe aktet në Këshill për vijimin e procedurave.

4. Në vijim të procedurës, Këshilli, për shkak të ndryshimit të përbërjes së Komisioneve të Përhershme, me vendimin e tij nr. 486, datë 13.09.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, në vijim me Vendimin nr.521, datë 24.09.2024, ka vendosur :

-Caktimin e Znj. Yllka Rupa relatores të procedurave të kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Z. Fatmira Luli, si më poshtë:

... ii. Z. {...}

4.1 Më datë 27.09.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit 424/2020, Z. {...} në rrugë elektronike, u njoftua për caktimin e relatorit të ri të kësaj procedure si dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

4.2 Po në rrugë elektronike, brenda afatit ligjor, kandidati parashtrori dakordësi dhe se nuk kishte ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e ri të caktuar për procedurën e verifikimit/kualifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Bazuar në rezultatet e verifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar se në kushtet kur kandidatja përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor

në kategorinë ndihmës ligjor; ka përfunduar me sukses programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor viti akademik 2023 - 2024 në Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 29, datë 30.07.2024 “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, e ka renditur në listën e kandidatëve fitues, duke e klasifikuar të gjashtin me 77.30 pikë; është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit të Këshillit nr. 469, datë 31.07.2024 “Për kualifikimin e kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor, Z. Klodiana Bytyçi”, është vendi për kualifikimin e kandidatit për emërimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit.

6. Sa sipër, në përfundim të procedurës së verifikimit për kualifikimin e kandidatit për emërimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 548 datë 01.10.2024 ka vendosur :

1. *Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të Z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.*

II. VLERËSIME MBI PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

7. Këshilli vlerëson se një ndër përgjegjësitë e tij të ngarkuara nga Kushtetuta e Republikës është dhe ajo lidhur me drejtimin dhe kujdesjen e mbarëvajtjes së punës në administratën e gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, dhe “ë”, ku theksohet se (citojmë): “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”

8. Në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor, i ndryshuar, që në nenin 1, pika 1, shkronja “d”¹ është parashikuar se një ndër qëllimet e tij kryesore, është edhe përcaktimi i rregullave lidhur me statusin e nëpunësve civil gjyqësor. Edhe nenet 50 deri në 63, ky ligj i dedikohet pikërisht statusit të nëpunësve civil gjyqësor në gjykatë. Në këto dispozita², lidhur me organin kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë *kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit* është ngarkuar të jetë Këshilli

¹ Neni 1, pika 1, shkronja “d” e Ligjit nr. 98/2016 parashikon se: “1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me: ... d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë”.

² Neni 50 i Ligjit nr. 98/2016, i ndryshuar parashikon se: 1. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit; e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median. 2. Statusi i nëpunësve civilë gjyqësorë rregullohet nga ky ligj.

i Lartë Gjyqësor. Kjo kompetencë është e sanksionuar në nenin 59 të këtij ligji ku theksohet se “*L. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.*”.

9. Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për *ndihmës ligjor*, ligji parashikon si të tilla, të njëjtat kriteret të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimit civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kriteret të veçanta për këtë kategori, kategorinë e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji i parashikuar në pikën 2 të nenit 56 të Ligjit Për Pushtetin Gjyqësor, i ndryshuar dhe që janë (citojmë): “*2. Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, kandidatët duhet të përmbushin këto kriteret të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barazvlefshëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare*”.

10. Sa më sipër, u parashtrua, rezulton se Këshilli ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha këto kriteret në lidhje me kandidatin për pranim në shërbimin civil gjyqësor Z. {...}, konkretisht :

10.1 Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë pranë Këshillit dhe më pas vetë Këshilli me vendimin e tij nr. 157, datë 04.04.2023, ka konstatuar faktin se Z. {...} plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji për të ndjekur Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023–2024, profili “*Ndhmës ligjor*”.

10.2 Në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli me vendimin nr. 469, datë 31.07.2024, ka vendosur kualifikimin e kandidatit fitues z. {...} dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor. Gjithashtu konstatohet se në përfundim të Shkollës së Magjistraturës, me Vendimin nr. 29, datë 30.07.2024 “*Vlerësimi përfundimtar për kandidatët për këshilltar dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024*”, Shkolla e Magjistraturës e ka vlerësuar kandidatin me 77.30 pikë (*më shumë se 70% të pikëve në total*).

10.3 Gjithashtu, Këshilli në përfundim të procedurës së verifikimit për kualifikimin e kandidatit për emërimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit, me vendimin nr. 548 datë 01.10.2024 ka vendosur kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit, në këtë mënyrë është plotësuar edhe një tjetër kriter i

përcaktuar nga ligji, të cilin duhet të plotësojnë kandidatët për t'u pranuar në shërbimin civil gjyqësor, kategoria “*Ndihmës ligjor*”.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar ndër të tjera dhe në parashikimet e vendimit të tij nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, me vendimin nr. 552 datë 01.10.2024 ka vendosur :

1. Shpalljen e 6 (gjashtë) vendeve vakante, në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit si më poshtë:

- *Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm - 3 (tre) pozicione për ndihmës ligjor;*
- *Në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit - 3 (tre) pozicione për ndihmës ligjor;*

11.1 Më datë 01.10.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin 424/2020, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për të drejtën që kishte për të përzgjedhur shprehur interesin për t'u caktuar në njërin nga pozicionet e shpallura vakante, me vendimin e mësipërm, brenda 1 (një) ditë nga marrja e këtij njoftimi.

11.2 Po në rrugë elektronike, brenda afatit ligjor, kandidati ka shprehur interesin e tij për caktimin në pozicionin si ndihmës ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

12. Lidhur me emërimin e ndihmësit ligjor, neni 59, pika 3 e Ligjit për Pushtetin Gjyqësor, parashikon se ajo kalon nëpërmjet një procedure *zgjedhjeje* nga Këshilli të kandidatëve të cilët paraqesin kërkesë. Në një rast të tillë Këshilli do të duhet të mbajë në konsideratë : *a) renditjen në listën e kandidatëve; b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese*”. Kjo procedurë e parashikuar nga ligji, mban në konsideratë rastin kur kemi *më shumë kandidatë sesa vende vakante të lira*, ndërkohë në rastin konkret, të caktimit në pozicion, për z. {...}, (*i cili ka shprehur interesin pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, por duke qenë se është renditur i fundit në listën e pikëzimit nga Shkolla, pozicion i lirë mbetet pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*) procedura e *zgjedhjes* e parashikuar nga pika 3 e nenit 59, të Ligjit të sipërcituar nuk ka vend për t'u zbatuar, pasi siç u theksua më lart, Shkolla e Magjistraturës, me Vendimin nr. 29, datë 03.07.2024 “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, e ka renditur atë, të gjashtin në listën e kandidatëve, me 77.30 pikë (*më shumë se 70% të pikëve në total*).

III. KONKLUZIONE

13. Bazuar në rezultatet e parashtruara më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se z. {...}, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë “Ndhmës ligjor”, në kushtet kur ai ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës dhe është kualifikuar për vijimin e procedurës së emërimit në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.

14. Referuar faktit që ai ka shprehur interesin të caktohet pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe kushteve dhe nevojave që ka kjo gjykatë, ku kontributi i ndihmësive ligjor konsiderohet i rëndësishëm, vlerësohet që pas caktimit në pozicionin e ndihmësit ligjor, ushtrimi i veprimtarisë së Z. {...} në këtë gjykatë, të fillojë menjëherë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “c” dhe “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 42, pika 1, 36 dhe 59 të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe në vendimin e Këshillit nr. 548, datë 01.10.2024 “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të z. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të Z. {...} dhe caktimin në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Z. {...} dhe Gjykatës Administrative të Apelit, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR